



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 102 Prot.

Tiranë, më 16.01.2026

**V E N D I M**

Nr. 3 , datë 16.01.2026

**PËR PËRFUNDIMIN E MBIKËQYRJES SË ORIENTUAR, ME OBJEKT  
ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË GJATË ZHVILLIMIT TË PROCEDURAVE TË  
PLOTËSIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL  
NËPËRMJET PRANIMIT NË NIVELIN EKZEKUTIV, LËVIZJES PARALELE,  
NGRITJES NË DETYRË DHE PRANIMIT NË KATEGORINË E LARTË  
DREJTUESE, TË PLANIFIKUARA PËR T’U ZHVILLUAR NGA BASHKIA  
TIRANË GJATË VITIT 2025.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 34, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, të miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, si dhe pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit, në lidhje me procesin e mbikëqyrjes së orientuar mbi zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në procedurat e pranimit në nivelin ekzekutiv, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në kategorinë e lartë drejtuese në shërbimin civil, të planifikuara për t’u zhvilluar nga Bashkia Tiranë gjatë vitit 2025,

**VËREJ SE:**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke vlerësuar rëndësinë e madhe të procesit të rekrutimit në krijimin e një administrate profesionale dhe efikase, si dhe të një shërbimi civil të qëndrueshëm, të bazuar në meritë, në lidhje me përsosjen më tej të sistemit të rekrutimit me qëllim rritjen e objektivitetit dhe transparencës, me urdhrin nr. 17 (74 prot.), datë 17.1.2025, urdhëroi “Mbikëqyrjen e orientuar”, më qëllim mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procesit të rekrutimit në institucionin e Bashkisë Tiranë, nëpërmjet

pranimi në shërbimit civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë të nëpunësve civilë përgjatë vitit 2025. Programi i mbikëqyrjes nr. 74/1 prot., datë 17.1.2025, i është njoftuar institucionit në monitorim me shkresën nr. 74/2 prot., datë 17.1.2025, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së orientuar mbi zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në konkurrimet e planifikuara për t’u zhvilluar nga Bashkia Tiranë, gjatë vitit 2025”.

Në zbatim të mbikëqyrjes në fjalë, grupi i punës ka monitoruar procedurat e konkurrimit për pranimin dhe emërimin në kategorinë ekzekutive; për lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese; si dhe, procedurat për pranimin në kategorinë e nivelit të lartë drejtues, të planifikuara për t’u zhvilluar nga Bashkia Tiranë gjatë vitit 2025.

Mbikëqyrja është realizuar duke administruar informacionin elektronik të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë, <https://tirana.al/kategori/punesimi>, seksioni Vende Pune - Shërbimi Civil; në portalin e AKPA-së <https://akpa.gov.al/vlp-njesite-e-qeverisjes-vendore/>; si dhe, nëpërmjet pjesëmarrjes së grupit të punës në fazën e testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë, në disa procedura konkurrimi të përzgjedhura për të gjitha nivelet e nëpunësisë në shërbimin civil.

Në këtë proces, në faqen e institucionit dhe në portalin e AKPA -së janë administruar të dhënat lidhur me publikimet e detyrueshme siç janë: • plani vjetor i pranimit në shërbimin civil; • shpallja e procedurës konkurrimit për çdo kategori dhe klasë të shërbimit civil; • shpallja e listës së kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim; • data e përcaktuar për testimin me shkrim dhe intervistën e strukturuar me gojë; si dhe, • lista e kandidatëve fitues.

Gjithashtu, në vijim të procesit të mbledhjes së të dhënave, grupi i punës, ka qenë i pranishëm në:

- procedurat e konkurrimit për pozicionet e kategorisë ekzekutive të shpallura me kod #229, 235 dhe 237;
- procedurat e konkurrimit për pozicionet e kategorisë së ulët apo të mesme drejtuese të shpallura me kod #230, 234 dhe 238; si dhe,
- procedurën e pranimit në kategorinë e nivelit të lartë drejtues për pozicionin “*Drejtor i Përgjithshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Administrimit të Brendshëm*”.

Në lidhje me këto procedura, grupi i punës mori pjesë në fazën e testimit me shkrim, si dhe në fazën e intervistës së strukturuar me gojë, të zhvilluara në datën dhe orën e caktuar, në ambientet e Bashkisë Tiranë, duke u mbajtur aktkonstatimi përkatës për secilën fazë.

Ky proces është zhvilluar edhe në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Procedurave të Burimeve Njerëzore, Trajnimit dhe Vlerësimit të Performancës si njësi organizative e ngarkuar me detyrën e planifikimit, organizimit dhe zhvillimit të konkurrimeve. Konstatohet se, kjo drejtori me urdhrat nr. 1378 (19452/1 prot.), datë 24.7.2025 dhe nr. 2008 (38755 prot.), datë 10.11.2025, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, ka kryer edhe detyrat e njësisë

përgjegjëse pasi pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm të Administrimit të Brendshëm ka qenë vend vakant.

Bashkëpunimi është realizuar nëpërmjet komunikimeve të vazhdueshme verbale, telefonike, shkresore dhe në rrugë elektronike nëpërmjet e-mail zyrtar, si dhe i është kërkuar njësisë përgjegjëse informacioni i nevojshëm për realizimin e mbikëqyrjes dhe sigurimin e dokumentacionit përkatës për të kryer hetimin administrativ.

## **I. Aspekte të përgjithshme dhe statistika në lidhje me procesin e rekrutimit**

Në zbatim të detyrimeve të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, me vendimin nr. 99 (6913 prot.), datë 10.2.2025, të Kryetarit të Bashkisë, “Për planin vjetor për plotësimin e vendeve të lira në shërbimin civil”, është miratuar plani vjetor i pranimit në shërbimin civil për vitin 2025, për institucionin Bashkia Tiranë. Referuar përcaktimeve të ligjit dhe aktit nënligjor, në bazë të këtij plani administrohet i gjithë procesi i rekrutimit në shërbimin civil.

Vendimi për miratimin e planit vjetor të punësimit për vitin 2025, është publikuar në Web-in e Bashkisë Tiranë, [https://tirana.al/uploads/2025/4/20250403140757\\_plani-vjetor-per-vende-te-lira-pune-1.pdf](https://tirana.al/uploads/2025/4/20250403140757_plani-vjetor-per-vende-te-lira-pune-1.pdf).

Në përputhje me përcaktimet e pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe pikës 43, kreu III, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, me vendimin nr. 98 (6912 prot.), datë 10.2.2025, të Kryetarit të Bashkisë, “Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil”, institucioni ka miratuar pozicionet e nivelit të ulët, të mesëm dhe të lartë drejtues, për cilat mund të aplikojnë edhe kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil. Gjatë vitit ky vendim është ndryshuar me vendimin nr. 399 (36263/1 prot.), datë 20.10.2025, “Për një ndryshim të vendimit nr. 98, datë 10.2.205 “Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e lartë, të ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil”. Me këto akte janë miratuar vendet e lira për kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese si dhe kategorinë e nivelit të lartë drejtues, për të cilët procedura e konkurrimit do të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira.

Vendimet e institucionit të cituara si më sipër, janë publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë, [https://tirana.al/uploads/2025/4/20250403140757\\_plani-vjetor-per-vende-te-lira-pune-1.pdf](https://tirana.al/uploads/2025/4/20250403140757_plani-vjetor-per-vende-te-lira-pune-1.pdf).

Planin vjetor i pranimit është përgatitur duke mbajtur parasysh nëpunësit që mbushin moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, krijimin e vendeve të reja të punës pjesë e shërbimit civil për shkak të ndryshimit të strukturës, si dhe krijimin e vendeve të lira për arsye të tjera. Mbi

këtë bazë, Bashkia Tiranë, ka planifikuar **122** pozicione të lira për rekrutim, gjatë vitit 2024, të ndara sipas kategorive të mëposhtme:

- Për kategorinë e lartë drejtues: **5** pozicione;
- Për kategorinë e mesme drejtuese: **6** pozicione;
- Për kategorinë e ulët drejtuese: **20** pozicione;
- Për kategorinë ekzekutive: **91** pozicione.

Njësia e burimeve njerëzore e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Brendshëm, (në vazhdim, njësia përgjegjëse), në zbatim të nenit 22, 25, 26 dhe 32, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; pikës 2, të kreut I, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar; pikës 3, të kreut I, të vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”; pikës 2, kreu III, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar; si dhe, në zbatim të pikës 3, të vendimit nr. 99 (6913 prot.), datë 10.2.2025, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, “Për planin vjetor për plotësimin e vendeve të lira në shërbimin civil”, ka organizuar konkurrimet për plotësimin e pozicioneve të lira të kategorisë ekzekutive, të ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, pranimin në shërbimin civil dhe ngritjes në detyrë, për pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas strukturës dhe organikës në fuqi të institucionit.

Më qëllim plotësimin e **122** vendeve vakante të shërbimit civil (pozicione të lira të kategorisë ekzekutive, të ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese), të planifikuara për t’u plotësuar gjatë vitit 2025, rezulton se njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë gjatë këtij viti ka shpallur **45** procedura konkurrimi. Këto konkurrime korrespondojnë me shpalljet e publikuara në faqen zyrtare të institucionit <https://tirana.al/punesimi/vende-pune>, seksioni Vende Pune - Shërbimi Civil me numër shpallje nga **214** deri në **238** dhe nga **250** deri në **263**, si dhe **5** procedura të publikuara në seksionin Shpallje për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e lartë drejtuese.

Nga verifikimi i kryer në faqen e internetit të institucionit dhe në portalin e AKPA-së, konstatohet se gjatë vitit 2025, kanë përfunduar **36** konkurrime të shpallura gjatë vitit 2025. Gjithashtu, gjatë këtij viti kanë përfunduar edhe **18** procedura konkurrimi të nisura në fund të vitit 2024 (procedurat e publikuara me #195, 196, 199, 200, 201, 203, 202, 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 211, 212 dhe 213). Në mënyrë më të detajuar, realizimi i procedurave të shpallura gjatë vitit 2025, paraqitet si më poshtë:

- **20 procedura konkurrimi**, kanë përfunduar, nëpërmjet publikimit të njoftimit të fituesit, deri në fund të vitit 2025.

- **9 procedura konkurrimi**, kanë përfunduar pa asnjë fitues (**4 procedura për kategorinë ekzekutive të publikuara me shpalljet #221, 228, 236 dhe 237; 2 procedura për kategorinë e ulët drejtuese të publikuara me shpalljet #226 dhe 227 dhe 3 procedura për pranim në kategorinë e lartë drejtuese**). Në këto raste, njësia përgjegjëse ka bërë njoftimin në faqen zyrtare të institucionit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, për përfundimin e konkurrimit pa asnjë fitues.
- **17 procedura konkurrimi**, të nisura në fund të vitit 2025, janë ende në proces realizimi, (konkretisht janë në proces: **7 procedura për vend të lirë në kategorinë ekzekutive, shpalljet #250, 251, 252, 253, 254, 262, 263**); **8 procedura për vend të lirë në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, shpalljet #255, 256, 257, 258, 259, 260, 261 dhe 262**); si dhe, **2 procedura për vend të lirë në kategorinë e lartë drejtuese**).

Për sa më sipër, në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë në realizimin e procedurave të konkurrimit, në përmbajtje të këtij relacioni do të trajtohen **29** procedura konkurrimi, të cilat rezultojnë të shpallura dhe të përfunduara gjatë vitit 2025.

Gjatë këtij viti, në adresë të Komisionerit nuk ka ardhur asnjë informacion nga nëpunës apo kandidatë që kanë marrë pjesë në procedurat e konkurrimit të organizuara nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë në lidhje me pretendime për parregullsi të lejuara apo të kryera gjatë zhvillimit të konkurremeve të organizuara nga institucioni në monitorim.

Për efekt të analizës së procesit, konkurrimet i grupojmë në këtë mënyrë:

- a) Lëvizja paralele dhe pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive;
- b) Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë për nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues; dhe,
- c) Pranimi në kategorinë e lartë drejtuese të shërbimit civil.

#### ***A. Lëvizja paralele dhe pranimi në shërbimin civil për pozicionet e nivelit ekzekutiv.***

Në nenet 22, 23 dhe 25, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe në vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, përcaktohen rregullat procedurale të konkurrimit, për plotësimin e pozicioneve të punës në nivelin ekzekutiv.

Sipas dispozitave të mësipërme ligjore, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive, bëhet së pari, nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele. Në rastin kur, në një procedurë konkurrimi, pozicioni/pozicionet e kategorisë ekzekutive plotësohen me procedurën e lëvizjes paralele njësia përgjegjëse (*Njësia e burimeve njerëzore për njësinë e qeverisjes vendore Bashkia Tiranë*), bën njoftimin në faqen e saj zyrtare dhe në portalin e AKPA-së, për përfundimin e konkurrimit me këtë procedurë. Ndërsa, në rast se, lëvizja paralele përfundon pa një fitues ose me më pak fitues se planifikimi atëhere konkurrimi vazhdon me procedurën e pranimin në kategorinë ekzekutive të shërbimit civil.

Nga monitorimi i publikimeve elektronike, rezulton se, për vitin 2025, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë ka shpallur **18** procedura konkurrimi për plotësimin e pozicioneve të kategorisë ekzekutive, si më poshtë:

1. “*Specialist i Mbrojtjes së Fëmijëve, Sektori i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, Njësia Administrative nr. 8*”, 1 (një) vend pune, publikuar me kod #214.
2. “*Specialist i Informimit Qytetar, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, Njësia Administrative Ndroq*”, 1 (një) vend pune, publikuar me kod #215.
3. “*Specialist, Sektori i Menaxhimit të Riskut dhe Mjeteve për Emergjencat, Fatkeqësitë Natyrore dhe Përshatjen Mjedisore, Drejtoria e Mjedisit, Parqeve dhe Rekreacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik, Investimeve të Huaja dhe Zhvillimit Ekonomik*”, 1 (një) vend pune, publikuar me kod #216.
4. “*Specialist, Drejtoria e Monitorimit të Medias, Drejtoria e Përgjithshme e Medias dhe Komunikimit me Qytetarët*”, 1 (një) vend pune, publikuar me kod #221.
5. “*Specialist, Sektori Urban, Drejtoria e Koordinimit të Legalizimit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit*”; “*Specialist, Sektori Rural, Drejtoria e Koordinimit të Legalizimit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit*”, 2 (dy) vende pune, publikuar me kod #222.
6. “*Specialist, Sektori Rural, Drejtoria e Koordinimit të Legalizimit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit*”; “*Specialist, Sektori Urban, Drejtoria e Koordinimit të Legalizimit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit*”, 2 (dy) vende pune, publikuar me kod #223.
7. “*Specialist, Drejtoria e Bashkëndimit dhe Koordinimit Administrativ*”, 1 (një) vend pune, publikuar me kod #228.
8. “*Specialist, Sektori Rural, Drejtoria e Koordinimit të Legalizimit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit*” 5 (pesë) vende pune; “*Specialist, Sektori Urban, Drejtoria e Koordinimit të Legalizimit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit*”, 5 (pesë) vende pune, publikuar me kod #229.
9. “*Specialist, Sektori i Komunikimit, Drejtoria e Medias dhe Komunikimit, Drejtoria e Përgjithshme e Medias dhe Komunikimit me Qytetarët*”, 1 (një) vend pune, publikuar me kod #235.
10. “*Specialist, Sektori i Gis, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Brendshëm*”, 1 (një) vend pune, publikuar me kod #236.
11. “*Specialist, Sektori i Apelimit Tatimor, Drejtoria e Ankimimeve, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit*”, 1 (një) vend pune, publikuar me kod #237.
12. “*Specialist, Sektori i Shqyrtimit të Lejeve Individuale dhe Rindërtimit, Drejtoria e Lejeve për Zhvillimin e Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit*”; “*Specialist, Sektori i Shqyrtimit të Lejeve Komplekse, Drejtoria e Lejeve për Zhvillimin e Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit*”, 2 (dy) vende pune, publikuar me kod #250.

13. “Specialist, Sektori i Asistencës Ligjore e Legjislacionit, Drejtoria e Ankimimeve, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit”, 1 (një) vend pune, publikuar me kod #251.
14. “Specialist, Sektori i Apelimit Tatimor, Drejtoria e Ankimimeve, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit”, 1 (një) vend pune, publikuar me kod #252.
15. “Specialist, Sektori i investimeve në Objektet Publike e Civile, Drejtoria e Investimeve të Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit, Investimeve dhe Monitorimit të Punëve Publike”. “Specialist, Sektori i Investimeve në Objektet Publike e Civile, Drejtoria e Investimeve të Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit, Investimeve dhe Monitorimit të Punëve Publike”, 2 (dy) vende pune, publikuar me kod #253.
16. “Specialist, Sektori i Monitorimit të Pastrimit të Mbetjeve Urbane, Drejtoria e Pastrimit dhe Mbetjeve Urbane, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit, Investimeve dhe Monitorimit të Punëve Publike”, 1 (një) vend pune, publikuar me kod #254.
17. “Specialist i Mbrojtjes së Fëmijëve, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, Njësia Administrative Zall-Herr”, 1 (një) vend pune, publikuar me kod #262.
18. “Specialist, Sektori i Netëerikut dhe Asistencës Teknike, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Brendshëm”; “Specialist, Sektori i Ekosistemit TECH, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Brendshëm”, 2 (dy) vende pune, publikuar me kod #263.

Në lidhje me ecurinë e realizimit të këtyre procedurave rezulton se **7** prej tyre kanë përfunduar me shpallje të kandidatit/kandidatëve fitues; **4** procedura kanë përfunduar pa asnjë të përzgjedhur fitues dhe **7** procedura janë në proces.

Gjithashtu, gjatë këtij viti kanë përfunduar edhe **8** procedura konkurrimi për plotësimin e pozicioneve të kategorisë ekzekutiv, të nisura në fund të vitit 2024, konkretisht procedurat e publikuara me shpalljet #195, 196, 199, 201, 205, 209, 211 dhe 213.

Referuar të dhënave që përmbajnë dokumentet e publikuara, siç janë në këtë rast, shpallja e procedurës së konkurrimit; lista e kandidatëve që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim; si dhe lista me renditjen e kandidatëve fitues, të dhënat në lidhje me pozicionet e nivelit ekzekutiv të plotësuara nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil të shpallura dhe të përfunduara gjatë viti 2025, janë si më poshtë:

**Tabela nr. 2:** Të dhëna për plotësimin e pozicioneve të nivelit ekzekutiv, nëpërmjet lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil.

Numri i vendeve vakante për	Numri i procedurave të	Numri i vendeve vakante	Numri i kandidatëve të kualifikuar nga	Numri i kandidatëve të shpallur fitues nga	Numri i kandidatëve të emëruar nga Njësia përgjegjëse
-----------------------------	------------------------	-------------------------	--	--	---

rekrutim (sipas planit të rekrutimit për vitin 2025)	përfunduar a gjatë vitit 2025.	për të cilat është organizuar konkurrimi i (sipas aktit të shpalljes)	Njësia përgjegjëse		KPLP/KPP		Emërimet në pozicionin ku kanë konkurruar	Emërimet nga lista e fituesve, e vlefshme
			Për lëvizje paralele	Për pranim në shërbim civil	Për lëvizje paralele	Për pranim në shërbimin civil		
91	11	22	6	76	3	45	18	51

Ndërkohë siç e kemi përmendur edhe më lartë në këtë material gjatë këtij viti kanë përfunduar me shpallje fituesi edhe 7 procedura konkurrimi për kategorinë ekzekutive të mbartura nga viti 2024, ku në përfundim të tyre njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktet e emërimit për kandidatët e renditur të parët në listën e fituesve. Gjithashtu, për plotësimin e vendeve vakante të kategorisë ekzekutive të krijuara për arsyet e paparashikuara në shkronjën “a” e “b”, të pikës 3, të VKM nr. 108, dt. 26.2.2014, njësia përgjegjëse bazuar në përcaktimet e pikës 16 e 18, kreu IV, të VKM nr. 143, dt. 18.3.2015, i ndryshuar, ka emëruar kandidatë nga Lista e fituesve e vlefshme/Lista e fituesve të konkurrimeve të mëparshme. Bazuar në përcaktimet e pikës 18, të kreut IV, të VKM nr. 143, dt. 18.3.2015, kandidati fitues ka të drejtë të qëndrojë në listën e fituesve për një periudhë 2 vjeçare. Referuar informacionit në lidhje me menaxhimin e proceseve të shërbimit civil të dërguar nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, rezulton se nga konkurrimet e përfunduara me fitues gjatë vitit 2025 dhe Lista e fituesve e vlefshme janë bërë 69 emërimet në kategorinë ekzekutive.

Pra gjatë vitit 2025 janë bërë gjithsej 69 emërimet në kategorinë ekzekutive ku në 18 raste, janë emëruar kandidatët të përzgjedhur fitues në pozicionin për të cilin kanë konkurruar dhe në 51 raste, janë emëruar kandidatët nga lista e fituesve e vlefshme.

Të dhënat e përgjithshme të analizuara si më sipër, kanë dalë nga përpunimi i të dhënave të nxjerra për çdo procedurë konkurrimi të realizuar në mënyrë periodike nga Bashkia Tiranë gjatë gjithë vitit 2025, të dhënat e Listës së fituesve që administrohet nga njësia përgjegjëse dhe informacionet në lidhje me menaxhimin e proceseve të shërbimit civil të dërguara nga njësia përgjegjëse.

*(Tabela nr. 1: “Procedura konkurrimi për pranim në kategorinë ekzekutive të shërbimit civil, të realizuara nga Bashkia Tiranë, gjatë vitit 2025”, e hartuar nga grupi i punës, Lista e fituesve e vlefshme dhe informacionet e dërguara nga njësia përgjegjëse, janë administruar në dosjen e këtij monitorimi).*

Nga këqyrja e akteve të publikuara, të dhënat e mbledhura, si dhe, dokumentacioni i administruar gjatë monitorimit, konstatohet se:

- Në shpalljen e vendit të lirë, është përcaktuar se, aplikohet në të njëjtën kohë për të dy procedurat (*lëvizje paralele, pranim në shërbimin civil*), duke përcaktuar për secilën procedurë afatin e dorëzimit të dokumenteve me datë të saktë kalendarike.

Në këtë rast, njësia përgjegjëse, **ka vepruar** në përputhje me rregullimet e pikës 1 dhe 2, të nenit 25, të ligjit për nëpunësin civil, ku parashikohet se, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive, bëhet së pari, nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe nëse në përfundim të kësaj procedure nuk ka një fitues, atëherë njësia përgjegjëse organizon procedurën e pranimit në shërbimin civil nëpërmjet konkurrimit të hapur. Në rastin konkret, për **6** procedura nuk janë paraqitur kandidatë për lëvizjen paralele, dhe për këtë shkak është vazhduar me procedurën e pranimit në shërbimin civil. Ndërsa, në **5** procedura konkurrimi (#214, 216, 223, 228 dhe 237) janë kualifikuar kandidatë për lëvizje paralele, ku konstatohet se konkurrimet me #214 dhe 216 kanë përfunduar me fitues nëpërmjet lëvizjes paralele; procedura me #223 e shpallur për dy pozicione, ka përfunduar me **1** fitues nëpërmjet lëvizjes paralele dhe **8** fitues nëpërmjet pranimit në shërbimin civil; ndërsa konkurrimet #228 dhe 237, kanë përfunduar pa asnjë fitues të përzgjedhur.

- Shpalljet e vendit të lirë të publikuara në portal dhe në faqen zyrtare të institucionit, **kanë të përfshirë** në pëmbajtjen e tyre të gjitha të dhënat e përcaktuara në pikën 9, të kreut II, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, si dhe kategorinë e pagës të pozicionit për të cilin është organizuar konkurrimi.
- Në të gjitha rastet e shpalljes së vendeve të lira, rezultoi se, **janë respektuar afatet** e parashikuara në pikën 8 e 10, të kreut II, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar dhe pika 9, kreu II, e VKM nr. 242, datë 18.3.2015, ku përcaktohet se, shpallja e procedurës së pranimit bëhet të paktën 35 ditë kalendarike para datës së parashikuar për zhvillimin e konkurrimit; afati i dorëzimit të dokumentacionit për lëvizje paralele jo më pak se 10 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes; për pranim në shërbimin civil jo më pak se 15 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes.

*Verifikimi paraprak i kandidatëve*, rezulton se **është realizuar** nga njësia e burimeve njerëzore, duke respektuar afatet ligjore të publikuara në shpalljen për pozicionin e lirë. Nga këqyrja e akteve, në këtë rast, konstatohet se:

- Verifikimi paraprak i kandidatëve është kryer brenda afatit prej 16 ditë kalendarike, nga data e mbylljes së pranimit të dokumentacionit, afat ky i përcaktuar në pikën 2, të kreut IV, të VKM nr. 243, dt. 18.3.2015, i ndryshuar.

Në të gjitha procedurat e zhvilluara, njësia përgjegjëse ka nxjerrë akte të verifikimit paraprak dhe akte të verifikimit përfundimtar në lidhje me dokumentet e dorëzuara nga kandidatët, duke njoftuar edhe datën, orën dhe vendin e zhvillimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.

- Në të gjitha rastet, Lista e verifikimit paraprak/verifikimit përfundimtar është shpallur në portalin AKPA dhe në faqen e internetit të institucionit, sipas përcaktimeve të pikës 4, kreu IV, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar.
- Në të gjitha rastet, Lista e fituesve është shpallur në portalin e AKPA dhe në faqen e internetit të institucionit, sipas përcaktimeve të pikës 14, kreu IV, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar.
- Në procedurën për lëvizje paralele në kategorinë ekzekutive, referuar verifikimit përfundimtar paraprak, konstatohet se për **22** pozicione të shpallura vetëm për **6** pozicione pune janë kualifikuar kandidatë. Kjo do të thotë, se në procedurën e lëvizjes paralele për të lëvizur brenda institucionit nga një sektor në tjetrin nuk kanë shprehur interes shumë kandidatë, duke u nisur nga fakti se, lëvizja paralele bëhet brenda të njëjtës kategori të nëpunësisë civile.
- Në procedurën për praninë në kategorinë ekzekutive të shërbimit civil, referuar verifikimit paraprak/final për **22** pozicione janë kualifikuar **76** kandidatë. Numri i lartë i kandidatëve tregon se, ka interes për tu punësuar në administratën e Bashkisë Tiranë, duke e parë si një mundësi për t'u zhvilluar profesionalisht e më tej për t'u bërë pjesë e administratës publike dhe pjesë nëpunësve të shërbimit civil.
- Konstatohet se njësia përgjegjëse në **6 raste**, ka bërë grupimin e pozicioneve të njëjta (*pozicione pune me emërtesë të njëjtë, të vendosura në të njëjtën drejtori dhe me kërkesa të posaçme të njëjta*) dhe ka organizuar një procedurë konkurrimi për disa pozicione. Në këtë rast bëhet fjalë për procedurat e shpallura me #222, 223, 229 250, 253 dhe 263 për pozicionet “*Specialist në Drejtorinë e Koordinimit të Legalizimit*”; “*Specialist në Drejtorinë e Lejeve për Zhvillimin e Territorit*”; “*Specialist në Drejtorinë e Investimeve të Punëve Publike*” dhe “*Specialist, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit*”. Në këtë rast Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, ka marrë masa për përmirësimin e punës në drejtim të zhvillimit të konkurrimeve në grup pozicionesh sipas orientimeve të dhëna në Raportin e Komisionerit në përfundim të procesit të mbikëqyrjes së orinetuar në lidhje me konkurrimet e zhvilluara gjatë vitit 2024.

Rezulton se, në procedurat e konkurrimit për vend të lirë në kategorinë ekzekutive, kanë shprehur interes për të marrë pjesë një numër i lartë kandidatësh. Për rrjedhojë, në përfundim të procesit përzgjedhës (*procesit të verifikimit të bërë nga njësia përgjegjëse dhe vlerësimin me shkrim e me gojë të bërë nga KPP*), ka rezultuar një numër i kënaqshëm kandidatësh fitues. Mbështetur në parashikimet e pikes 18, kreu IV, të VKM nr. 243, dt. 18.5.2015, i ndryshuar, njësia përgjegjëse për kandidatët e vlerësuar me rezultatin më të lartë mbi 70 pikë, ka nxjerrë aktin e emërimit në pozicionin përkatës ku ai ka konkurruar, ndërsa kandidatët e tjerë të përzgjedhur fitues me 70 pikë e lartë i ka regjistruar në Listën e fituesve, vlefshmëria e së cilës është për një periudhë deri në dy vjet. Më pas, në rastin e krijimit të vendeve të lira nga grupi i pozicioneve të administrimit të përgjithshëm/posaçëm, njësia përgjegjëse ka

përzgjedhur dhe emëruar kandidatin fitues që ka mbetur në listë dhe që i përshtatet kërkesave të vendit të punës. Përzgjedhja e kandidatëve është bërë në bazë të renditjes së tyre në listë sipas pikëve.

➤ ***Konkurrimet për vend vakant në kategorinë ekzekutive të përzgjedhura për të marrë pjesë në testimin me shkrim dhe testimin me gojë.***

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes përveç monitorimit online të konkurrenive të organizuara në mënyrë periodike nga Bashkia Tiranë gjatë gjithë vitit, grupi i punës, ka përzgjedhur për të marrë pjesë në fazën e testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë **3** (tre) procedura konkurrimi.

Në këtë proces, u përzgjedhën konkurrenime për pozicione të kategorisë ekzekutive të klasifikuara në grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm si dhe pozicione të klasifikuara në grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm, të publikuara elektronikisht në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë dhe në portalin e AKPA-së me #229, 235 dhe 237. Në lidhje me këto procedura, grupi i punës ka monitoruar momentet kryesore procedurale të fazës së dytë të konkurrimit që është vlerësimi i kandidatëve të kualifikuar për konkurrim.

Me qëllim dokumentimin e procesit të mbikëqyrjes, u administruan kopje të akteve të hartuara gjatë zhvillimit të fazave të procedurës, si dhe u hartuan aktkonstatimet përkatëse të mbajtura ndërmjet grupit të punës dhe një përfaqësuesi të njësisë përgjegjëse të institucionit. Dokumentacioni i administruar në lidhje me realizimin e procedurës së pranimit në shërbimin civil, si dhe aktkonstatimet e hartuara në datën e realizimit të testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë, janë administruar si pjesë e materialeve të kësaj mbikëqyrje.

Procedurat e konkurrimit në të cilat grupi i punës ka marrë pjesë në fazën e testimit me shkrim apo intervistën e strukturuar me gojë, janë të evidentuara si më poshtë:

1. Procedura e pranimit në shërbimin civil e organizuar për **10** vende të lira në Drejtorinë e Koordinimit të Legalizimit, në Drejtorinë e Përgjithme Juridike të Aseteve dhe Licensimit (5 pozicione për “Specialist në Sektorin Rural” dhe 5 pozicione për “Specialist në Sektorin Urban”), lloji i diplomës “Shkenca Inxhinierike/Juridike/Ekonomike”, niveli minimal i diplomës “Master Profesional”, publikuar me shpalljen #229. Procedura e konkurrimit publikuar në datë 5.6.2025. Lista e kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim, shpallur në datë 30.6.2025, testimi me shkrim organizuar në datë 14.7.2025 dhe intervista me gojë në datë 17.7.2025, shpallja e kandidatëve të përzgjedhur fitues me mbi 70 pikë (mbi 70% të pikëve), në datë 30.7.2025.

Për këtë procedurë konkurrimi grupi i punës ka qenë i pranishëm në fazën e testimit me shkrim të organizuar në datën 14.7.2025 dhe në fazën e intervistës së strukturuar me gojë të organizuar në datën 17.7.2025.

2. Procedura e pranimit në shërbimin civil e organizuar për **1** pozicion “*Specialist në Sektorin e Komunikimit*”, në Drejtorinë e Medias dhe Komunikimit, lloji i diplomës “*Arsim i Lartë*”, niveli minimal i diplomës “*Master Profesional*”, publikuar me shpalljen #235. Procedura e konkurrimit publikuar në datë 20.6.2025. Lista e kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim për pranim në kategorinë ekzekutive, shpallur në datë 16.7.2025, testimi me shkrim organizuar në datë 29.7.2025 dhe intervista me gojë në datë 1.8.2025, shpallja e kandidatëve të përgjedhur fitues me mbi 70 pikë (*mbi 70% të pikëve*), në datë 15.8.2025.

Për këtë procedurë konkurrimi grupi i punës ka qenë i pranishëm në fazën e testimit me shkrim të organizuar në datën 29.7.2025 dhe në fazën e intervistës së strukturuar me gojë të organizuar në datën 1.8.2025.

3. Procedura e pranimit në shërbimin civil e organizuar për **1** pozicion “*Specialist në Sektorin e Apëlimit Tatimor*”, në Drejtorinë e Ankimimeve, lloji i diplomës “*Shkenca Juridike/Ekonomike*”, niveli minimal i diplomës “*Master Profesional*”, publikuar me shpalljen #237. Procedura e konkurrimit publikuar në datë 25.6.2024. Lista e kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim për pranim në kategorinë ekzekutive, shpallur në datë 25.7.2025, testimi me shkrim organizuar në datë 1.8.2024, intervista me gojë në datë 4.8.2025, procedura ka përfunduar pa kandidat fitues, sipas njoftimit të bërë në datë 15.8.2025.

Për këtë procedurë konkurrimi grupi i punës ka qenë i pranishëm në fazën e testimit me shkrim të organizuar në datë 1.8.2025.

Në lidhje me procedurat e konkurrimit si më sipër, (*konkurrimet për vend të lirë të shpallura me #229, 235 dhe 237*), është monitoruar organizimi dhe realizimi i testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP).

Legjislacioni i shërbimit civil, konkretisht pika 4, e nenit 22, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe kreu III, i vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, i Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emëimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar, përcaktojnë se KPP është organ kolegjal, i cili ka për detyrë dhe përgjegjësi realizimin e fazës së dytë të konkurrimit që është vlerësimi i kandidatëve që i nënshtrohen kësaj faze të konkurrimit.

Gjatë procesit të monitorimit në subjekt, grupi i punës ka administruar dokumentacionin si më poshtë:

- Aktin për shpallje vendi/vendeve të lira në kategorinë ekzekutive të shërbimit civil.
- Aktin për rezultatet e verifikimit paraprak/final për lëvizje paralele në kategorinë ekzekutive të shërbimit civil.
- Aktin mbi rezultatet e verifikimit paraprak/final për pranimin në kategorinë ekzekutive të shërbimit civil.

- Aktin për krijimin e Komitetit të Përhershëm të Pranimit (KPP).
- Testin e pyetjeve me shkrim dhe çelësin e përgjigjeve të hartuar nga KPP.
- Aktin për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të KPP.
- Procesverbalin e KPP për konstatimin e situatave të veçanta.
- Testin e pyetjeve për intervistën e strukturuar me gojë.
- Deklaratën mbi regjistrimin/mosregjistrimin e intervistës me gojë për kategorinë ekzekutive.
- Tabelën e pikëve për çdo kandidat, vlerësimin për testimin me shkrim, vlerësimin për dokumentacionin dhe vlerësimin për intervistën e strukturuar me gojë, të hartuar nga KPP.
- Raportin e vlerësimit përfundimtar të kandidatëve, të hartuar nga KPP.

Gjithashtu është monitoruar organizimi i testimit me shkrim dhe me gojë si dhe infrastruktura dhe kushtet e nevojshme për zhvillimin e konkurrimit.

Disa të dhëna në lidhje me numrin e kandidatëve të kualifikuar për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive të shërbimit civil, numrin e kandidatëve të paraqitur në testimin me shkrim, numrin e kandidatëve të vlerësuar në testimin me shkrim me mbi 30 pikë, numrin e kandidatëve të paraqitur në intervistën me gojë dhe numrin e kandidatëve fitues i kemi paraqitur në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 3:** Të dhëna në lidhje me zhvillimin e fazës së dytë të konkurrimit për procedurën pranimit në kategorinë ekzekutive shërbimit civil.

Nr.	Nr. i shpalljes (Pozicioni "Specialist")	Testimi me shkrim		Intervista me gojë		Nr. i kandidatëve fitues (me mbi 70 pikë)
		Nr. i kandidatëve të kualifikuar	Nr. i kandidatëve të paraqitur	Nr. i kandidatëve të kualifikuar (mbi 45 pikë)	Nr. i kandidatëve të paraqitur	
1	229	27	17	16	15	13
2	235	8	8	4	4	3
3	237	4	1	0	0	0

Të dhënat e mësipërme, në lidhje me kandidatët që kanë marrë pjesë në këto konkurrenca për pozicione të kategorisë ekzekutive tregojnë se, ka interes për tu punësuar në administratën e Bashkisë Tiranë. Një pjesëmarrje e dëshirueshme krijon mundësinë e përzgjedhjes së kandidatëve më të mirë e për pasojë rekrutimin e punonjësve eficientë.

Gjatë procesit të këqyrjes së dokumentacionit që materializon veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe KPP, për realizimin e fazës së dytë të konkurrimit (*testimit me shkrim dhe intervistës me gojë*), është konstatuar se:

Institucioni në monitorim, në zbatim të rregullave të parashikuara nga pika 4, e nenit 22, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe kreu III, i vendimit nr. 243, datë

18.3.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emëimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, **ka ngritur KPP-në** me 5 anëtarë, me përbërje si më poshtë:

- 1 anëtar nga njësia e burimeve njerëzore, kryesues i KPP-së;
- 2 anëtarë, janë zgjedhur nëpunës civilë të institucionit (të nivelit të mesëm drejtues);
- 2 anëtarë, ekspertë të fushës (janë zgjedhur pedagogë të universiteteve, duke marrë në konsideratë karakteristikat e secilit pozicion për të cilin është zhvilluar konkurrimi).

Njësia përgjegjëse, ka njoftuar Komitetin e Përhershëm të Pranimit për datën, orën, vendin e zhvillimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë si dhe për listën e kandidatëve të kualifikuar.

Anëtarët e caktuar në aktin për krijimin e KPP-së, në asnjë rast nuk kanë qenë në kushtet e pamundësisë ligjore për të qenë anëtarë të KPP-së, për këtë arsye nuk ka qenë e nevojshme zëvendësimi i tyre. KPP-ja, në të gjitha rastet, i ka marrë vendimet në praninë e të gjithë anëtarëve të tij.

Sipas dispozitave ligjore, cituar më sipër, totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- *Deri në 15 pikë*, për vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve (CV) që konsiston në vlerësimin e arsimimit, përvojës e trajnimeve, të lidhura me fushën e njohurive, aftësive dhe cilësive të përfshira në shpalljen për konkurrim.
- *Deri në 60 pikë*, për vlerësimin me shkrim (një testim i shkruar).
- *Deri në 25 pikë*, për intervistën e strukturuar me gojë.

Në fund të procedurës së vlerësimit kandidati nuk konsiderohet fitues nëse nuk ka marrë mbi 70 pikë (mbi 70% të pikëve). Gjithashtu, në dispozitat ligjore si më sipër, parashikohet se, në intervistën e strukturuar me gojë, kanë të drejtë të marrin pjesë kandidatët, të cilët kanë grumbulluar në vlerësimin me shkrim më shumë se gjysmën e pikëve (*mbi 30 pikë*).

Në rastin konkret, KPP-ja, **ka organizuar dhe mbikëqyrur** vlerësimin për testimin me shkrim, vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe atë të intervistës me gojë.

Për kryerjen e *vlerësimit me shkrim* të kandidatëve, anëtarët e KPP, **kanë përgatitur/hartuar testet** përkatëse, të cilat, në të gjitha rastet, janë hartuar me zgjedhje dhe janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komitetit të përhershëm. Komiteti ka hartuar edhe çelësin e përgjigjeve. Pyetjet janë hartuar brenda fushës së njohurive dhe aftësive mbi të cilat do të zhvillohej testimi, të përfshira në shpalljen për konkurrim. Anëtarët e KPP **kanë korrigjuar** testet dhe **kanë vlerësuar** në mënyrë individuale kandidatët duke dhënë pikët për secilin.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se, në vlerësimin me shkrim, anëtarët e KPP, kanë zbatuar rregullat e pikës 8, të paragrafit III/6, të udhëzimit të DAP, duke pjesëtuar shumën totale të pikëve me pesë (në bazë të numrit të vlerësuesve).

Në përfundim të këtij testimi, si dhe të vlerësimit të jetëshkrimit (*i cili është bërë sipas modelit të vlerësimit në Aneksin nr. 4, bashkëlidhur udhëzimit të DAP*), **kanë renditur kandidatët**, të cilët kanë grumbulluar më shumë se 45 pikë.

Në lidhje me *intervistën me gojë*, KPP, ka vepruar në këtë mënyrë:

- **Ka hartuar** pyetjet që lidhen me njohuritë, aftësitë, eksperiencën që nevojiten për pozicionin e punës dhe që janë brenda fushës së testimit të publikuara në shpallje, të cilat janë të nevojshme për të gjithë kandidatët.
- Brenda afateve të parashikuara, KPP, **ka zhvilluar** intervistën me gojë me secilin nga kandidatët dhe më pas ka hartuar raportin e procedurës së zhvilluar duke bërë vlerësimin, i cili, sipas udhëzimit të DAP, është i njëjtë me atë të lëvizjes paralele, por shuma totale, në këtë rast, pjesëtohet me pesë (*numri i vlerësuesve*).
- Në të gjitha rastet, anëtarët e KPP, **kanë nënshkruar** deklaratën e paanësisë, duke deklaruar se nuk kanë konflikt interesi me kandidatët në konkurrencë.
- Në të gjitha rastet, kandidatët **kanë nënshkruar** deklaratat e pranimit ose mospranimit për të regjistruar intervistën me gojë.

Në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, KPP, **ka listuar** kandidatët fitues me mbi 70 pikë (*mbi 70% të pikëve*) dhe brenda afateve, ja ka dërguar njësisë së burimeve njerëzore, e cila, listën e fituesve, e **ka shpallur** në portalin AKPA dhe në faqen e internetit të institucionit.

**Konkluzion:** Grupi i punës vlerëson se:

- Njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë dhe KPP, gjatë realizimit të procedurave për pranimit në kategorinë ekzekutive të shërbimit civil, **kanë zbatuar kërkesat e ligjit** nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar; si dhe, të udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të DAP.

*(Të dhënat/gjetjet e konstatuara nga dokumentet e shpallura/botuara në faqen e internetit të institucionit dhe portalin e AKPA, siç janë: shpallja e procedurës, lista e kandidatëve që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrencë dhe lista me renditjen e kandidatëve fitues, janë evidentuar në Tabelën nr. 1:*

*“Procedura konkurrimi për pranim në kategorinë ekzekutive të shërbimit civil, të realizuara nga Bashkia Tiranë, gjatë viti 2025”, e hartuar nga grupi i punës dhe që është pjesë e dosjes së mbikëqyrjes).*

### ***B. Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues.***

Rregullat procedurale të konkurrimit për të plotësuar pozicionet e punës në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues, në vijim procedurat e ngritjes në detyrë (*duke përfshirë dhe lëvizjen paralele në këtë kategori*), janë të parashikuara në nenet 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*, i ndryshuar.

Sipas përcaktimeve të mësipërme ligjore, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë. Në rast të mosplotësimit të vendit të lirë, vijohet me procedurën e ngritjes në detyrë nga nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin institucion apo në një institucion tjetër të shërbimit civil.

Nga monitorimi i vazhdueshëm i faqes së internetit të institucionit dhe portalit të AKPA-së, rezulton se, për vitin 2025, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë ka shpallur **20** procedura konkurrimi për plotësimin e pozicioneve të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, si më poshtë:

1. *“Përgjegjës i Sektorit Urban, në Drejtorinë e Koordinimit të Legalizimit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit”*, publikuar me kod #217.
2. *“Përgjegjës i Sektorit të Apelimit Tatimor, në Drejtorinë e Ankimimeve, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit”*, publikuar me kod #219.
3. *“Përgjegjës i Sektorit të Ankimimeve Administrative, në Drejtorinë e Ankimimeve, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit”*, publikuar me kod #220.
4. *“Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, Njesia Administrative nr. 8”*, publikuar me kod #226.
5. *“Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit Ekonomik Urban, në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik Investimeve të Huaja dhe Zhvillimit Ekonomik”*, publikuar me kod #227.
6. *“Përgjegjës i Sektorit të Dixhitalizimit dhe Lëvizshmërisë së Qëndrueshme, në Drejtorinë e Makroplanifikimit Vendor, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Tiranë”*, publikuar me kod #230.
7. *“Përgjegjës i Sektorit të Sekretariatit Teknik, në Drejtorinë e Monitorimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”*, publikuar me kod #232.

8. *“Përgjegjës i Sektorit të Lejeve të Zhvillimit, në Drejtorinë e Studimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”, publikuar me kod #233.*
9. *“Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Shëndetësore në Komunitet, në Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile dhe Shërbimeve ndaj Qytetarit”, publikuar me kod #238.*
10. *“Përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Sistemeve të Institucioneve të Varësisë dhe Ndërmarrjeve Shtetërore, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm”, publikuar me kod #261.*
11. *“Përgjegjës i Sektorit Auditimit të Sistemeve të Institucioneve të Varësisë dhe Ndërmarrjeve Shtetërore, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm”, publikuar me kod #262.*
12. *“Drejtor i Drejtorisë së Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit”, publikuar me kod #218.*
13. *“Drejtor i Drejtorisë së Mjedisit Parqeve dhe Rekreacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik, Investimeve të Huaja dhe Zhvillimit Ekonomik”, publikuar me kod #224.*
14. *“Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Brendshëm”, publikuar me kod #225.*
15. *“Drejtor i Drejtorisë së Makroplanifikimit Vendor, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”, publikuar me kod #234.*
16. *“Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Brendshëm”, publikuar me kod #255.*
17. *“Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve të Huaja, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit, Investimeve dhe Monitorimit të Punëve Publike”, publikuar me kod #257.*
18. *“Drejtor i Drejtorisë së Rrjeteve dhe Planifikimit të Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit, Investimeve dhe Monitorimit të Punëve Publike”, publikuar me kod #258.*
19. *“Drejtor i Drejtorisë së Pastrimit dhe Mbetjeve Urbane, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit, Investimeve dhe Monitorimit të Punëve Publike”, publikuar me kod #259.*
20. *“Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Brendshëm”, publikuar me kod #260.*

Shpalljet për vend të lirë pune pjesë e shërbimit civil në faqen e institucionit dhe në portal, janë të identifikuara me numrin përkatës i cili rritet në mënyrë progresive. Për shkak të numrit të madh të procedurave të shpallura (20 procedura të shpallura, ku 13 prej tyre kanë përfunduar me fitues), të dhënat në lidhje me numrin dhe datën e shpalljes së procedurës, afatin e dorëzimit të dokumenteve për lëvizje paralele dhe për ngritje në detyrë, kandidatët e kualifikuar për secilën procedurë, datën e testimit me shkrim dhe intervistës me gojë, si dhe shpalljen e listës së kandidatëve fitues me mbi 70 pikë, janë materializuar në Tabelën nr. 2: “Procedura konkurrimi për plotësimin e vendeve të lira të kategorisë së ulët dhe të mesme

drejtuese të shërbimit civil, të realizuara nga Bashkia Tiranë, gjatë viti 2025”, e cila është pjesë e dosjes së këtij monitorimi.

Gjithashtu, gjatë këtij viti kanë përfunduar edhe **10** procedura konkurrimi për plotësimin e pozicioneve në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, që kanë nisur në fund të vitit 2024, konkretisht, procedurat e publikuara me shpalljet #198, 200, 202, 203, 204, 206, 207, 208, 210 dhe 212.

Disa të dhëna të mbledhura gjatë procesit të monitorimit “online” të konkurremeve për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, për **13** shpallje të përfunduara, grupi i punës i ka paraqitur në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 3:** Të dhëna për procedurën e plotësimit të vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

Numri i vendeve vakante për rekrutim (sipas planit të rekrutimeve për vitin 2024)	Numri i procedurave të përfunduara gjatë vitit 2025.	Numri i kandidatëve të kualifikuar nga Njësia përgjegjëse		Numri i kandidatëve të shpallur fitues nga KPLP/KPND		Numri i kandidatëve të emëruar nga Njësia përgjegjëse
		Për “Lëvizje paralele”	Për “Ngritje në detyrë”	Për “Lëvizje paralele”	Për “Ngritje në detyrë”	
26	13	1	25	1	10	11

\* Numri i kandidatëve fitues/kandidatëve të emëruar është më i vogël se numri i procedurave të përfunduara pasi 2 procedura kanë përfunduar pa asnjë fitues.

Në referencë të planit vjetor, miratuar me vndimin nr. 99 (6913 prot.), datë 10.2.2025, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, “Për planin vjetor për plotësimin e vendeve të lira në shërbimin civil”, rezultojnë të jenë përcaktuar **26** pozicione të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese për t’u plotësuar nëpërmjet procedurave të konkurrimit gjatë këtij viti. Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën e mësipërme, konstatohet se, njësia përgjegjëse ka organizuar dhe përfunduar **13** procedura konkurrimi për pozicionet e klasifikuara në këto kategori, ku në **1** rast konkurrimi ka përfunduar me lëvizje paralele, në **20** raste me procedurën e ngritjes në detyrë dhe në **2** raste konkurrimi ka përfunduar pa një fitues.

Nga të dhënat e administruara rezulton se, numri i pozicioneve të planifikuara për konkurrim është **26**, numri i pozicioneve të shpallura për konkurrim është **20** dhe numri i pozicioneve për të cilët kanë përfunduar procedurat e konkurrimit është **13**.

Konstatohet se, plani vjetor i pranimit për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese nuk është realizuar pasi me urdhrin nr. 3492 (49222 prot.), datë 24.12.2024, të kryetarit të Bashkisë Tiranë, “Për miratimin e strukturës organike të institucionit të Bashkisë së Tiranës”, është

miratuar struktura organike e Aparatit të Bashkisë së Tiranës, duke përcaktuar fillimin e efekteve financiare të strukturës së re në datën 3.2.2025. Në këto rrethana, Njësia përgjegjëse ka filluar organizimin e procedurave të konkurrimit pasi ka përfunduar sistemimi i punonjësve ekzistues në strukturën e re. Gjithashtu, gjatë vitit 2025, u realizuan zgjedhjet e përgjithshme për deputet në Kuvendin e Shqipërisë dhe për periudhën zgjedhore 11.4.2025 - 11.5.2025, procedurat e konkurrimit janë pezulluar.

➤ ***Procedura e ngritjes në detyrë edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil.***

Në pikën 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe pikën 43, kreu III, të vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, përcaktohet se, organi kompetent për institucionet e pavarura, mund të vendosë që në procedurën e ngritjes në detyrë të konkurrojnë edhe kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira. Në çdo rast plotësimi i vendeve të lira në këtë kategori nuk mund të kalojë 20 për qind të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik.

Në referencë të përcaktimeve të mësipërme ligjore, rezulton se, institucioni në monitorim, me vendimin nr. 98 (6912 prot.), datë 10.2.2025, “Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil”, ka miratuar pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm dhe drejtues, për cilat nëse procedura e lëvizjes paralele do të përfundonte pa një fitues, procedura e ngritjes në detyrë të jetë e hapur dhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil.

Në zbatim të akteve të mësipërme ligjore, rezulton se nga **26** procedura konkurrimi të planifikuara për plotësimin e pozicioneve të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues njësia përgjegjëse në **4** raste (që zënë 15% të pozicioneve të lira të nivelit të mesëm dhe të ulët), ka bërë të njohur se procedura e konkurrimit është e hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil. Konkretisht, është vijuar plotësimi me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, për vendet e lira të publikuar me shpalljet #220, 224, 226 dhe 227. Në lidhje me këto procedura, vërejmë se, njësia përgjegjëse ka mbajtur parasysh përcaktimet e pikës 43, kreu III, të aktit nënligjor, pasi për plotësimin e këtyre vendeve, ka patur vendim të veçantë të titullarit të institucionit.

➤ ***Konkurrimet për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese të përzgjedhura për të marrë pjesë në testimin me shkrim dhe testimin me gojë.***

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes grupi i punës ka monitoruar online **20** konkurrenca për vend të lirë punë në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese të shpallura gjatë këtij viti nga Bashkia Tiranë, ku **3** prej tyre, (**1** i kategorisë së mesme drejtuese dhe **2** të kategorisë së ulët drejtuese), janë përzgjedhur për të mbikëqyrur nga afër fazën e testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë. Konkretisht u përzgjedhën procedurat e shpallura me #230, 234 dhe 238.

Në lidhje me këto procedura është administruar gjithë dokumentacioni që materializon realizimin e konkurrimit që nga shpallja e vendit të lirë e deri tek nxjerrja e aktit të emërimit për kandidatin fitues, si dhe janë hartuar aktkonstatimet përkatëse të këqyrjes të mbajtura ndërmjet grupit të punës dhe një përfaqësuesi të njësisë përgjegjëse të institucionit. Ky dokumentacion është administruar si pjesë e dosjes së mbikëqyrjes.

Më konkretisht grupi i punës ka marrë pjesë në fazën e dytë të konkurrimit (testimin me shkrim dhe intervistën me gojë), të zhvilluar për pozicionet:

1. *“Përgjegjës i Sektorit të Dixhitalizimit dhe Lëvizshmërisë së Qëndrueshme”*, në Drejtorinë e Makroplanifikimit Vendor, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, lloji i diplomës, *“Shkenca Inxhinierike/Gjeodezi”*, niveli minimal i diplomës *“Master Profesional”*, të përfitur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, të ketë eksperiencë mbi 1 vit në fushën përkatëse, shpallja #230. Procedura e konkurrimit publikuar në datë 12.6.2025. Lista e kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim për ngritje në detyrë, shpallur në datë 30.6.2025, testimi me shkrim dhe intervista me gojë në datë 14.7.2025, shpallja e fituesit në datë 29.7.2025.

Për këtë procedurë konkurrimi grupi i punës ka qenë i pranishëm në fazën e dytë të konkurrimit në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë të organizuar në datë 17.7.2025.

2. *“Drejtor i Drejtorisë së Makroplanifikimit Vendor”*, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, lloji i diplomës, *“Inxhinieri Ndërtimi”/“Arkitekturë/Urbanistikë”*, niveli minimal i diplomës *“Master Shkencor”*, të ketë eksperiencë mbi 3 vite në fushën përkatëse, shpallja #234. Procedura e konkurrimit publikuar në datë 12.6.2025. Lista e kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim për ngritje në detyrë, shpallur në datë 14.7.2025, testimi me shkrim dhe intervista me gojë në datë 17.7.2025, shpallja e fituesit në datë 25.7.2025.

Për këtë procedurë konkurrimi grupi i punës ka qenë i pranishëm në fazën e dytë të konkurrimit në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë të organizuar në datë 17.7.2025.

3. *“Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Shëndetësore në Komunitet”*, në Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile dhe Shërbimeve ndaj Qytetarit, lloji i diplomës *“Shkenca Sociale”*, niveli minimal i diplomës *“Master Profesional”* të përfitur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, të ketë eksperiencë në fushën përkatëse, shpallja #238. Procedura e konkurrimit publikuar në datë 25.6.2025. Lista e kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim për levizje paralele, shpallur në datë 7.7.2025, testimi me shkrim dhe intervista me gojë në datë 21.7.2025, shpallja e fituesit në datë 28.7.2025.

Për këtë procedurë konkurrimi grupi i punës ka qenë i pranishëm në fazën e dytë të konkurrimit në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë të organizuar në datë 21.7.2025. Në lidhje me konkurrimet e realizuara me procedurën e ngritjes në detyrë, (*konkurrimet për vend të lirë të shpallura me #230, 234 dhe 238*), është monitoruar organizimi dhe realizimi i testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë nga Komiteti i Pranimi për Ngritjen në Detyrë (KPND).

Legjislacioni i shërbimit civil, konkretisht pika 6, e nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe kreu III, i vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, i Këshillit të Ministrave, "*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*", i ndryshuar, përcaktojnë se KPND është organ kolegjal, i cili ka për detyrë dhe përgjegjësi realizimin e fazës së dytë të konkurrimit që është vlerësimi i kandidatëve që i nënshtrohen kësaj faze të konkurrimit.

Bazuar në përcaktimet e pikës 7, kreu III, të VKM nr. 242, dt. 18.3.2015, i ndryshuar, Komiteti i Pranimi për Ngritjen në Detyrë (KPND), përbëhet nga pesë anëtarë: a) 1 anëtar nga njësia përgjegjëse, i cili kryeson komitetin; b) 1 anëtar i zgjedhur nga titullari midis nëpunësve civilë të institucionit, nëse është e mundur të nivelit të mesëm drejtues; c) eprorin direkt të pozicionit për të cilin zhvillohet konkurrimi; d) 2 ekspertë të fushës përkatëse, në varësi të fushës së vlerësimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, KPND, në çdo rast, është ngritur në përputhje me përcaktimet ligjore, i cili kryesohet nga Drejtori i Drejtorisë së Procedurave të Burimeve Njerëzore, Trajnimit dhe Vlerësimit të Performancës. Gjithashtu konstatohet se, ekspertët janë zgjedhur pedagogë të universiteteve duke patur në konsideratë karakteristikat e pozicionit për të cilin do të zhvillohet procedura e konkurrimit, dhe nisur nga ky fakt, në shumicën e rasteve janë pedagogë të Universitetit të Tiranës.

Në bazë të përcaktimeve të pikës 6, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, pikave nga 27 deri në 33, të kreut III, të VKM nr. 242, dt. 18.3.2015, i ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të DAP, kandidatët e kualifikuar për të kaluar në fazën e dytë të konkurrimit, vlerësohen nga KPND, ku përfshihet: a) Vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, përvojës e trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve individuale në punë (20 pikë); b) Vlerësimi me shkrim (40 pikë); c) Intervista e strukturuar me gojë (40 pikë). Në fund të procedurës së vlerësimit kandidati nuk konsiderohet fitues nëse nuk ka marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve).

Në rastin konkret, KPND, ka organizuar dhe realizuar vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, vlerësimin për testimin me shkrim, si dhe atë të intervistës me gojë. Për kryerjen e vlerësimit me shkrim të kandidatëve, anëtarët e KPND, kanë përgatitur testet përkatëse, të cilat, kanë qenë pyetje me zgjedhje, të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e komitetit. Komiteti ka hartuar edhe çelësin e përgjigjeve. Pyetjet janë hartuar brenda fushës së njohurive dhe aftësive, kompetencave, mbi të cilat do të zhvillohej testimi, të përfshira në

shpalljen për konkurrim. Anëtarët e KPND kanë korrigjuar testet dhe kanë vlerësuar në mënyrë individuale kandidatët duke dhënë pikët për secilin.

Gjatë realizimit të vlerësimit me shkrim, anëtarët e KPND, kanë zbatuar rregullat e pikës 8, të paragrafit III/6, të udhëzimit të DAP, duke pjesëtuar shumën totale të pikëve me pesë (*në bazë të numrit të vlerësuesve*). Në përfundim të këtij testimi, si dhe të vlerësimit të jetëshkrimit (*i cili është bërë sipas modelit të vlerësimit në Aneksin nr. 7, bashkëlidhur udhëzimit të DAP*), kanë rradhitur kandidaturat, të cilët janë kualifikuar për fazën e intervistës me gojë.

Në lidhje me intervistën me gojë, KPND, ka vepruar në këtë mënyrë: • Ka hartuar pyetjet që lidhen me njohuritë, aftësitë, eksperiencën që nevojiten për pozicionin e punës dhe që janë brenda fushës së testimit të publikuara në shpallje, të cilat janë të njëjta për të gjithë kandidatët. • Brenda afateve të parashikuara, KPND, ka zhvilluar intervistën me gojë me secilin nga kandidatët dhe më pas ka hartuar raportin e procedurës së zhvilluar duke bërë vlerësimin, i cili, sipas udhëzimit të DAP, është i njëjtë me atë të lëvizjes paralele, por shuma totale, në këtë rast, pjesëtohet me pesë (*numri i vlerësuesve*). • Në të gjitha rastet, anëtarët e KPND, kanë nënshkruar deklaratën e paanësisë, duke deklaruar se nuk kanë konflikt interesi me kandidatët në konkurrim.

Në lidhje me 3 procedurat e monitoruara në vend rezulton se të gjithë kandidatët kanë nënshkruar deklaratën se nuk pranojnë që intervista të rgjistrohet.

Në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, KPND, ka renditur kandidatët, duke filluar nga kandidati me rezultatin më të lartë dhe brenda afateve, ja ka dërguar njësisë së burimeve njerëzore, e cila, ka njoftuar individualisht kandidatët që kanë konkurruar, për rezultatin e tyre nëpërmjet e-mail. Më pas, njësia e burimeve njerëzore ka shpallur fituesin në faqen e internetit të institucionit dhe në portalin AKPA-së, dhe njëkohësisht ka dalë dhe akti i emërimit nga njësia përgjegjëse.

**Konkluzion:** Vlerësojmë se, procedurat e konkurrimit për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, janë zhvilluar në zbatim të rregullave të parashikuara në nenin 26, të ligjit për nëpunësin civil, kreun III, të VKM nr. 242, datë 18.3.2015, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, si dhe kreun V, të udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*”.

Në pjesën më të madhe të procedurave të ngritjes në detyrë, janë shpallur fitues, punonjës ekzistues brenda institucionit gjë që tregon për funksionimin e sistemit të karrierës, duke i dhënë mundësinë nëpunësve civilë me rezultate të larta, të zhvillojnë karrierën e tyre në shërbimin civil.

Përsa i përket procedurave të ngritjes në detyrë, të zhvilluara me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, vërejmë se, njësia përgjegjëse ka mbajtur parasysh përcaktimet e pikës 43, kreu III, të aktit nënligjor, pasi për plotësimin e këtyre vendeve, ka patur vendim të veçantë të titullarit të institucionit.

### **C. Pranimin në kategorinë e lartë drejtuese të shërbimit civil.**

Në nenin 32, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar përcaktohet se, pranimi në kategorinë e nëpunësve civilë të lartë drejtues në njësitë e qeverisjes vendore bëhet me konkurrim të organizuar për një apo disa pozicione të lira dhe është i hapur për nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese. Përyjashtimisht, titullari/organi vendimmarrës i institucionit mund të vendosë që procedura e pranimit të jetë e hapur edhe për kandidatët e tjerë, jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në këtë kategori, por në asnjë rast ky numër nuk mund të jetë më shumë se 15 për qind të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kategorisë së lartë drejtuese për atë institucion. Konkurrimi organizohet në përputhje me nenin 20 të këtij ligji nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit.

Më tej, në kreun III, të vendimit 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së*”, i ndryshuar, është parashikuar se, procedura e pranimit është e organizuar në dy faza, në fazën seleksionuese dhe në atë konkurruese. Bazuar në planifikimin vjetor të njësisë së qeverisjes vendore, procedura e pranimit në kategorinë e lartë zhvillohet sipas nevojave të vetë institucionit.

Referuar planit vjetor, të miratuar me vendimin nr. 99 (6913 prot.), datë 10.2.2025, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, “*Për planin vjetor për plotësimin e vendeve të lira në shërbimin civil*”, rezulton se për vitin 2025, janë planifikuar për rekrutim në kategorinë e lartë drejtuese **3** pozicione pune.

Nga monitorimi i vazhdueshëm i faqes së internetit të institucionit dhe portalit të AKPA-së, rezulton se, për vitin 2025, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë ka shpallur **5** procedura konkurrimi për plotësimin e pozicioneve të kategorisë së lartë drejtuese, si më poshtë:

1. “*Drejtor i Përgjithshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Mbrojtjes Civile dhe Shërbimeve, ndaj Qytetarit*”, shpallja e procedurës publikuar në datë 3.2.2025.
2. “*Sekretar i Përgjithshëm në Bashkinë e Tiranës*”, shpallja e procedurës publikuar në datë 3.2.2025, *rishpallur* në datë 26.3.2025.
3. “*Drejtor i Përgjithshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme Juridike, të Aseteve dhe Licensimit*”, shpallja e procedurës publikuar në datë 27.3.2025, *rishpallur* në datë 25.11.2025.
4. “*Drejtor i Përgjithshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Administrimit të Brendshëm*”, shpallja e procedurës publikuar në datë 16.7.2025.

5. “Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”, shpallja e procedurës publikuar në datë 17.10.2025.

Procedurat e konkurrencës për këto pozicione janë shpallur në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë dhe në portalin e AKPA-së.

Nga monitorimi *online*, konstatohet se, njësia përgjegjëse ka zbatuar procedurat e përcaktuara në nenin 32, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në vendimin nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND”, i ndryshuar, në lidhje me:

- Shpalljen e procedurës së pranimit në faqen e internetit të institucionit dhe portalin e AKPA, të paktën 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara datës të parashikuar për zhvillimin e konkurrencës.
- Përcaktimin në përmbajtjen e aktit të shpalljes të të dhënave të nevojshme në lidhje me përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës, kriteret e përgjithshme, kërkesat specifike të pranimit, si dhe kushtet dhe kërkesat e veçanta, aftësitë, njohuritë e cilësitë, që kandidatët duhet të zotërojnë për të aplikuar në konkurrencën për pranimin në kategorinë e nëpunësve civilë të lartë drejtues në njësitë e qeverisjes vendore.
- Publikimin e listës së kandidatëve që plotësojnë kërkesat specifike për të vijuar më tej me fazën e dytë të konkurrencës, vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.
- Publikimin e listës së kandidatëve të shpallur fitues në përfundim të procedurës së vlerësimit me pikë, duke garantuar të drejtën e ankimit, për kandidatët të cilët nuk janë shpallur fitues.

Konstatohet se në **2** raste, procedura ka qenë e hapur vetëm për nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese të shërbimit civil, ndërsa në **3** raste procedura ka qenë e hapur edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil. Njësia përgjegjëse duhet të tregojë kujdes që numri i pozicioneve për të cilat mund të aplikojnë edhe kandidatë jashtë shërbimit civil, nuk mund të jetë më i madh se 15% e numrit të përgjithshëm të pozicioneve të kategorisë së lartë drejtuese të institucionit.

Grupi i punës ka mbikëqyrur nga afër testimin me shkrim dhe intervistën e strukturuar me gojë, të zhvilluara në datë 16.9.2025, për plotësimin e pozicionit “Drejtor i Përgjithshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Administrimit të Brendshëm”. Gjatë testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë, u konstatua se: • në konkurrencë morën pjesë **5** kandidatë të kualifikuar për këtë procedurë; • teza ishte e sekretuar dhe pyetjet ishin me alternativa dhe brenda fushës së njohurive të përcaktuara në shpalljen e pozicionit të lirë; • kandidatëve pjesëmarrës ju vu në dispozicion “Deklarata për regjistrimin e intervistës së strukturuar me gojë”, të cilën e nënshkruan secili; • teza me pyetjet për intervistën e strukturuar me gojë

ishite brenda fushës së përcaktuar në shpallje. Kjo procedurë ka përfunduar pa fitues pasi asnjë kandidat nuk është vlerësuar me mbi 70 pikë.

➤ ***Publikimi elektronik i informacionit në lidhje me rekrutimin, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë të nëpunësve civilë.***

Publikimi i detyrueshëm elektronik i shpalljes së procedurës së konkurrimit për çdo pozicion të shërbimit civil, duke bërë të njohur edhe planin e zhvillimit të procedurës për secilin pozicion; publikimi i listës me emrat e kandidatëve, të cilët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës; si dhe i listës së fituesve në portalin e AKPA-së, në faqen e internetit të bashkisë dhe në standat e informimit të publikut, është parashikuar në dispozitat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar; vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar; vendimit 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar; si dhe, udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike.

Respektimi i kësaj procedure është një tregues real i transparencës së konkurrimeve, pasi i krijon mundësinë kandidatëve, apo çdo shtetasi të interesuar, të njihet me shpalljen për një pozicion vakant në administratën publike, të njihet me kandidatët që do marrin pjesë në konkurrim dhe të njihet me fituesit në këtë proces. Gjithashtu, respektimi i kësaj procedure garanton zbatimin e parimeve të shanseve të barabarta dhe transparencës, të përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Për të mbikëqyrur këtë proces, u monitoruan **29** procedura konkurrimi të përfunduara, (11 konkurrime për vend të lirë në kategorinë ekzekutive, 13 konkurrime për vend të lirë në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, 5 konkurrime për pranim në kategorinë e lartë drejtuese të shërbimit civil), të publikuara me #114 e në vijim, në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë <https://tirana.al/kategori/punesimi>, seksioni **Vende Pune - Shërbimi Civil** dhe në portalin e AKPA për të verifikuar nëse është realizuar nga Bashkia Tiranë, publikimi elektronik i të gjithë informacionit që i përket rekrutimit, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë të nëpunësve civilë dhe pranimit në kategorinë e lartë drejtuese të shërbimit civil.

Nga monitorimi i vazhdueshëm, në **29** raste të konkurrimeve për vende pune të shërbimit civil të shpallura nga Bashkia Tiranë gjatë vitit 2025 dhe të përfunduara me shpallje fituesi/përfundimin e procedurës pa asnjë fitues, rezultoi se:

- a) Njësia përgjegjëse, në të gjitha rastet, ka publikuar shpalljen e procedurës së konkurrimit në faqen e internetit të institucionit dhe në portalin e AKPA-së, duke bërë të njohur edhe planin e zhvillimit të procedurës për secilin pozicion.
- b) Në përfundim të fazës së verifikimit paraprak, në të gjitha rastet, njësia përgjegjëse ka publikuar në faqen e internetit të institucionit dhe në portalin e AKPA-së, listën me emrin e kandidatit/kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës, të renditur sipas rendit alfabetik.
- c) Në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve nga komisionet përkatëse, në të gjitha rastet, njësia përgjegjëse ka publikuar në faqen e internetit të institucionit dhe në portalin e AKPA-së, listën e kandidatëve fitues (*listën paraprake/listën finale të kandidatëve të fitues*), duke i renditur ata sipas pikëve të grumbulluara duke filluar nga ai me më shumë pikë.

Pas publikimit të listës finale të fituesve dhe përfundimit të afateve të ankimit në gjykatën administrative, njësia përgjegjëse, ka vijuar procesin duke ftuar fituesin që të japë miratimin për pozicionin për të cilin ka konkurruar. Më pas, ka dalë akti i emërimit, i cili është finalizuar me nxjerrjen e aktit të fillimit të marrëdhënieve financiare nga titullari i institucionit.

Këto ishin rrethanat e konstatuara nga Komisioneri gjatë procesit të mbikëqyrjes së orientuar mbi mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procesit të rekrutimit në institucionin e Bashkisë Tiranë, përgjatë vitit 2025.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në vlerësim të rrethanave të mësipërme si dhe dokumentacionit të administruar në kuadër të mbikëqyrjes së orientuar, arrin në konkluzionin se, procesi i rekrutimit të nëpunësve civilë, të zhvilluar nga Bashkia Tiranë, është kryer në zbatim të procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë aspekt të ligjit.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 34, të rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit, e ndryshuar,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e mbikëqyrjes së orientuar, filluar me Urdhrin nr. 17 (74 prot.), datë 17.1.2025, “Për fillimin e mbikëqyrjes së orientuar mbi zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në procedurat e pranimit në nivelin ekzekutiv, lëvizjes

*paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në kategorinë e lartë drejtuese në shërbimin civil, të planifikuara për t'u zhvilluar nga Bashkia Tiranë gjatë vitit 2025”, pa vendim paralajmërues, pasi nuk u konstatuan parregullsi në administrimin e shërbimit civil, të asaj natyre që të çënojnë thelbin e procesit.*

2. Të njoftohet për këtë vendim, Bashkia Tiranë, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Lefterije Lleshi (Luzi)**